

Bazuar në dispozitat e nenit 108/A par. 1 dhe 3.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92-së dhe dispozitat nga neni 4 i Rregullave për parashtrim të ankesave –në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit lidhur me këtë lëndë, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues Grupi i operatorëve ekonomik “AOME” SH.P.K., Gjeravica në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit lidhur me këtë lëndë, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues - dhënie të kontratës i datës 24/09/2020si dhe dorëzimit të Kërkesës për Rishqyrtim të datës 29/09/2020 paraqet:

### ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: : Komuna e Vushtrrisë Republika e Kosovës Për Aktivitetin e

Prokurimit: VU 644 – 20 – 2120 – 1-1-1 dhe

Nr. i brendshëm: 644/20/022 – 111

Sa i përket tenderit për: Furnizim me dru për ngrohje

### ANKESË


1. **Identifikimi i ankuesit\*** *Operatorëve Ekonomik “AOME” SH.P.K. ; Gjeravica Kolovicë 10000 Prishtinë*

*Komuna e Prishtinës  
(Vendi)  
049 84 04 93*

*aomeshpk-ks@outlook.com  
(Adresa elektronike)*

*14/10/2020  
(Data e parashtrimit të ankesës)*

*10000  
(Kodi postar)*



*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

*Njoftim për kontratë publike është publikuar më 28/05/2020 në ueb faqen e platëformës elektronike të KRPP-së;*

*Procesverbali i hapjes së ofertave më 29/06/2020;*

*Hapja e ofertave është bërë me datë 29/06/2020 në selinë e autoritetit kontraktues Komuna e Vushtrrisë;*

*Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues - dhënie të kontratës i datës 24/09/2020;*

*Letër standarde për tenderuesin e eliminuar në emër të operatorit ekonomik “AOME” SH.P.K. , Gjeravica*

*Kriteri për dhënien e Kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët;*

*Kërkesa për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues e datës 29/09/2020*

*Vendim – përgjigje në kërkesen për rishqyrtim*

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

☒

Jo

☐

*Është organizuar procesi i hapjes publike të ofertave. Asnjëri nga Operatorët Ekonomik të pranishëm në procesin e hapjes publike të ofertave nuk ka pasur vërejtje.*



## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shitesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:*

Po



Jo



## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Pas pranimit Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues - dhënie të kontratës i datës 29/09/2020 u njoftuam se përsëri pas ri-vlerësimit keni propozuar që me kontratë publike të shpërblehet oferta e operatorit ekonomik Milaim Bejta B.I. emri i "biznesit Bushegu89" për shumën e ofetës së tij 152,914.00€ për aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me dhe nr. i brendshëm: 644/20/022 - 111 Ne në cilësinë e OE-së konsiderojmë se shpallja Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues - dhënie e kontratës i datës 29/09/2020 i publikuar në platformën elektronike të KRPP-së më 29/09/2020 nga autoriteti kontraktues komuna Komuna e Vushtrisë Republika e Kosovës është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së si dhe të gjitha dispozitat tjera dhe aktet tjera nën ligjore që kanë të bëjnë me prokurimin publik në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë keni dëmtuar rëndë interesin material-financiar të kompanisë në fitimin e kontratës publike në mënyrë të rregullt dhe ligjore. Shkeljet e dispozitave ligjore nga Autoriteti kontraktues komuna e Komuna e Vushtrisë Republika e Kosovës

\* Është shkelur neni 1 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (qëllimi,shfrytëzimi më efikas, më transparent dhe më i drejtë i fondeve publike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92

\* Është shkelur neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (ekonomiciteti dhe efikasiteti i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

\* Është shkelur neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve) .

\* Është shkelur neni 41 i RRUOPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).

- Është shkelur neni 17 i Rregullores për Prokurimin Publik, paragrafi 1, 2 dhe 3
- \* Është shkelur neni Neni 52 (Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës) i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,
- \* Është shkelur neni Neni 62 (Ndërprerja e procedurave të prokurimit) i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,
- \* Është shkelur neni 44 i RRUOPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).
- \* Është shkelur neni Neni 65 (Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve) i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92
- \* Është shkelur neni Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,
- \* Është shkelur neni Neni 72 (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë) i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,
- \* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

*Në këtë përshkrim të shkeljeve të konstatuara më tepër do të përgendrohemi në shkeljet të cilat kanë ndodhur lidhur me Nenin 59 Është shkelur neni Neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, Në njoftimin për kontratë të publikuar në web fagen e platformës elektronike të autoritetit kontraktues Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës; dhe në dokumentet të cilat përbëjnë dosjen e tenderit:*

*Ju në B58 – Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues Dhënie e kontratës publike Letër Standarde për tenderuesin kandidatin e eliminuar të datës 24/09/2020 në*

### ARSYETIM

*(Ju jeni diskualifikuar) (tenderi i juaj është refuzuar) për këto arsye:*

*Grup i operatorëve ekonomik AOME SH.P.K. ;*

*“Komisioni vlerësues gjatë ri-vlerësimit të ofertave të këtij AP, te oferta e juaj ka konstatuar si në vijim: Më tepër iu keni referuar vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së me numër të protokollit 596/20 të datës 18/09/2020 i cili vendim është bazuar në raportin e ekspertit shqyrtues i cili e ka*



*vu në lajthitje panelin shqyrtues të OSHP-së i cili raport konsideron se furnizimi me pelet nuk është i njëjtë si furnizimi me dru. Peleti ashtu si edhe druri janë produkte që shërbejnë për ngrohje, çka don të thotë se peleti është derivat i drurit.*

*Është kështu njëjtë sikur të thuhet një kontratë furnizimi me benzinë ndryshon nga një kontratë furnizimi me naftë ose nuk janë furnizime të njëjta.*

*Të bashkangjitur me këtë Ankesë do të gjeni edhe një njoftim shkrim të cilin rubrika e RTK-së BETIMI për DREJTËSI e ka publikuar me datë 10 korrik 2017, ku ka informuar për të kaluarën kriminale të pronarit të kompanisë z. Milaim Bejta B.I. emri i "biznesit Bushegu89" oferten të cilën ju e keni propozuar që të shpërblehet me kontratë si dhe denimin që i është shqiptuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë.*

*Ne kërkuam nga Gjykata Themelore në Gjakovë që të na mundësoi qasje opo të na jap vendimin në bazë të të cilit ishte dënues pronari i kompanisë z. Milaim Bejta B.I. emri i "biznesit Bushegu89".*

*Pas kërkesës të cilën ia kemi drejtuar Gjykata Themelore në Gjakovë na kanë udhëzuar si të kyqemi në system nga ku kemi shkarkuar Vendimin P.nr. 759/17 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë që mban date 05/12/2017*

*Provë: Vendimin P.nr. 759/17 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë që mban datë 05/12/2017*

*Në vendimin – përgjigje në kërkesë për rishqyrtim të datës 05/10/2020 dhe numër K.R.022/2020 nuk ka dhënë ndonjë sqarim shtesë pse oferta jonë është eliminuar, Më tepër iu keni referuar vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së me numër të protokollit 596/20 të datës 18/09/2020 i cili vendim është bazuar në raportin e ekspertit shqyrtues i cili e ka vu në lajthitje panelin shqyrtues të OSHP-së*

*Një interpretim të cilin e ka dhënë KRPP-ja*

*Sipas nenit 17 të Rregullores për Prokurimin Publik, paragrafi 1, 2 dhe 3 përmbajnë dispozita që flasin për Procesin e Ri-vlerësimit si në vijim: 1. Autoritetet kontraktuese mund të përdorin vetëm kërkesa, kritere dhe specifikacione të publikuara ose parashtruara në dosjen e tenderit gjatë përzgjedhjes së tenderëve dhe dhënies së kontratës. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit. 2. Dispozita e përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së përfshirë një urdhër për ri-vlerësim në pajtim me Nenin 105, paragrafi 2.8, të LPP. 3. Në situata siç janë specifikuar në paragrafin 2 të këtij Neni, ri-vlerësimi mund të çojë në rezultat të ndryshëm vetë në aspektin e procesit të përzgjedhjes dhe dhënies, kur kushtet kanë ndryshuar. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar". Në bazë të nenit 17 të Rregullores për Prokurim Publik:*

*Autoriteti kontraktues konsiderohet se ka respektuar vendimin e OSHP-së nëse ka bërë një proces ri-vlerësimi (kur vendimi i OSHP-se e ka kërkuar këtë) duke marrë për bazë vendimin e OSHP-së lidhur me pretendimet e bëra në ankesë, Autoriteti kontraktues duhet të respektoj vendimin e OSHP-se për pretendimet e bëra dhe varësisht nga ndikimi të marrë një vendim të ri-vlerësimit i cili nuk nënkupton me doemos ndryshimin në rezultatin fillestar. Gjatë procesit të ri-vlerësimit , një*

ndryshim në rezultatin fillestar mund të ndodhë duke marrë për bazë shqyrtimin e pretendimeve në Vendimin e OSHP-se nga i cili dalin fakte apo prova të reja për të cilat AK-ja nuk ka qenë në dijeni gjatë procesit të vlerësimit fillestar dhe /ose një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Çdo justifikim i mundshëm i juaji në cilësinë e Zyrtarit Përgjegjes të Prokurimit nuk mund të mbështet me asnjë normë ligjore dhe as etike — profesionale, këtë duhet të keni parasysh ngase jeni duke ushtruar një funksion publik që iu është besuar të ushtroni profesionin, të kryeni detyrat me kompetencë dhe përgjegjësi, ndërmëri, besnikëri dhe në pajtim me ligjin.

Ju z. Dallku në cilësinë e Zyrtarit Përgjegjes të Prokurimit të autoritetit kontraktues Kuvendi Komunal Vushtrri duhet të jeni të vetdijshëm se mund të bartni pasoja deri të marrja e përkohshme e certifikatës themelore të profesionalizmit në prokurim.

\* Është shkelur neni Neni 65 (Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve) i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92

1. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara;

1.1. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin 1. të nenit 130 të këtij ligji sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;

1.2. është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rëndë profesionale e konstatuar nga një gjykatë kompetente;

1.3. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme në vendin ku ndodhin ato; ose

1.4. është shpallur fajtor për mashtrim apo një akt të ngjashëm me mashtrim nga një gjykatë kompetente;

Kur është në pyetje shkelja e neneve:

\* Është shkelur neni Neni 62 (Ndërprerja e procedurave të prokurimit) i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

“2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit”;

\* Është shkelur neni 44 i RRUOPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).  
44.6 Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave mund të anulohet për arsye të mëposhtme:

“të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK”



*Autoriteti kontraktues komuna Vushtrri – Drejtoria e Prokurimit propozon që me kontratë publike të shpërblehet oferta e operatorit ekonomik Milaim Bejta B.I. emri i "biznesit Bushegu89" për shumën e ofetës së tij 152,914.00€ e cila ofertë e tejkalon dukshëm shumën e planifikuar të autoritetit kontraktues e cila shumë është: 137,774.00€*

Neni 72

*Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.
3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit në pikën

### **III.2.2. Përshtatshmëria profesionale**

Kërkesa 4. Dëshmi të lëshuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës që op. Ek.përkatës nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjoredhe se nuk ka obligime të pa kryera ndaj Agjencionit nga kontratat e mëhershme.

**Dëshmia 2. Një vërtetim të lëshuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës duhet dorëzuar në original.**

Operatori Ekonomik Milaim Bejta B.I. emri i "biznesit Bushegu89". Shihet se me dosje të tenderit fare nuk e ka dorëzuar këtë vërtetim, ndërsa autoriteti kontraktues Komuna e Vushtrrisë – Drejtoria e prokurimit i kërkon sqarime shtesë me datë 17/07/2020 dhe krenohet e një vërtetim të tillë e sjellë në kohë rekorde me datë 21/07/2020 dhe nuk e dinë se është bërë kërkesë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, përkatësisht

Neni 72

*Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*

Paragrafi 3 i këtij neni i cili thotë:

2. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

*Nërsa eksperti shqyrtues i OSHP- e trajton si ofertë të përgjegjshme dhe ankesën të bazuar të operatorit ekonomik Operatori Ekonomik Milaim Bejta B.I. emri i "biznesit Bushegu89".*



Në bazë të të gjitha atyre që u shtjelluan më lartë kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së të bie:

#### VENDIM

- MIRATOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik "AOME" SH.P.K., Gjeravica Prishtinë
  - ANULOHEM Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues - dhënie të kontratës i datës 24/09/2020;
  - ANULOHEM Vendimi letër standarde për tenderuesin e eliminimit "AOME" SH.P.K., Gjeravica të mirren masa adekuate (për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset që aktiviteti i lartcekur i prokurimit – lënda të kthehet në ri-vlerësim pas ri-vlerësimit nga ana e autoritetit kontraktues të shpërblehet oferta e Operatorit Ekonomik "AOME" SH.P.K Gjeravica" si ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët që i ka plotësuar të gjitha kriteret e specifikuar në njoftimin për kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit.
- ANULOHEM Vendimi – përgjigja në kërkesë për rishqyrtim e datës 05/09/2020

#### 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

Dëmet materiale janë të konsiderueshme që kanë të bëjnë me përgatitjen e dosjes së tenderit:

Përgatitja e Kërkeses për Rishqyrtim,

Përgatitja e kësaj ankese,

Dëmet më të mëdha do t'i shkatohen operatorit ekonomik Grup i operatorëve ekonomik "AOME" SH.P.K. & N. T. SH. "TINI", Gjeravica 10000 Prishtinë Republika e Kosovës nëse nuk do të vlerësohet ofertë e përgjegjshme për aktivitetin e lartëcekur të prokurimit.

Të gjitha dëmet materiale do të konstatohen nga ekspertët financiar dhe të prokurimit përkatës në varshmëri të zhvillimit të procedurës në të ardhmën.

#### Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
- b) një kopje të publikimit për Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - dhënie të kontratës i datës 24/09/2020 ;*
- c) një kopje të letrës standarde për ofertuesin e eliminuar*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve,*
- e) e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*
- f) Kopje e Kërkesës për Rishqyrtim të dërguar pranë Autoritetit Kontraktues me datë 29/09/2020*
- g) Vendim - Mbi Pezullimin e Aktivitetit të prokurimit i datës*
- h) Vendimi – përgjigja në kërkesë për rishqyrtim e datës 05/10/2020*
- i) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*